

**XHA FER DEVA
DHE NGJARJET E
4 SHKURTIT 1944**

Përgatiti **Astrit Jegeni**





Astrit Jegeni

Tiranë 7.11.2024

4 Shkurt 1944

Historiografia enveriste e kishte të nevojshëm të sundonin mbi mëndjen e njerëzve për ti penguar ata të arsyetonin. Ky kontroll mbi inteligjencën e njerëzve e kishin të nevojshëm për të ruajtur privy-legjet e tyre. Të ekspozuar ndaj gënjeshtreve të racio-nalizuara dhe kamuflimeve të së vërtetës ndaj historisë sonë që na u servirën nën maskën e diturisë nga Prof. Dok. të shumtë e shumë “shokë” ku pandershmëria flliste e flet në emër të ndershmërisë, reaguam.

Duke u marë me studimin e ngjarjes së 4 shkurtit 1944 realisht po meremi me “mitin” e ndër-tuar

nga enveristët që kishin humbur cilësinë (fuq-inë) e dyshimit. Të jesh i pa qartë, i ngatarruar është shenjë e keqe, është një shenjë inferioriteti intelektual. Në “mit” impulse primitive nuk shprehen hap-tazi por maskohen e në rastin tonë u “dokmatizuan”.

Epistemologjia (greq) si koncept filozofik merret me studimin dhe rishqyrtimin e natyrës së diturisë dhe marrëdhëniet e saj me të vërtetën, Epistemologjia në rastin tonë po e përdorim në kuptimin a kemi besim te fjalët që janë shkruar e folur për ngjarjen e 4 shkurtit 1944?. Unë shtroj pyetjen “çfarë dinë njerëzit për këtë ngjarje a e besojnë variantin propogandistik të historiografisë Enveriste?” Duke qenë mosbesues për të vërtetën e kësaj ngjarje sipas variantit propogandistik banal që dhe sot gjallojnë lodhshëm jam munduar që të dhënat e dokumentuara që kam gjetur e përshtatur për këtë studim ti paraqes në frymën e “Kontekstualizmi” i cili si koncept filozofik përshkruan një mori këndvështrimesh por që theksojnë kontekstin në të cilin ndodh një veprim, dhe argumenton se, në disa aspekte të rëndësishme, veprimi, mund të kuptohet vetëm në lidhje me atë kontekst pa rënë në relati-vizëm. Të menduarit sistematik për këtë ngjarje më çoi në logjikën që ti vlerësoja të gjitha pjesët që ndëlidhen me 4 shkurtin e vitit 1944 për të arritur në një vetëdijë më të madhe për ngjarjen dhe pyetjet që shoqëron çdo ngjarje e këtyre përmasave. Ku qëndron e vërteta?

Vazhdimisht vrasjet masive të kryera nën ndikimin e urrejtjes politike e përzjerë me banalitetet krahinizmash mesjetare mbartin në kohë dhimbje pa fund, dhe ndjenja e hakmarjes dhe e shpagimit nuk

shuhet kurrë. Fatkeqësisht politika envriste këto akte dhune në historinë e kombit tonë i ka manipuluar për interesat e veta antikombëtare. Ne shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore kemi disa shembuj të tillë vrasjesh masive të kryera me njëri tjetrin të tipit "ndëshkimor" e "frikësues" të bëra në situata të tensionuara politike si nga ana e forcave partizane të drejtuara nga komunistët dhe nga kundërshtarët e tyre politikë. Në thelb shumica e vrasjeve gjatë luftës së Dytë Botërore në Shqipëri që janë bërë nga forcat jo të rregullta ushtarake janë akte banditeske. Këto forca nuk i njihnin e nuk i respektonin aktet e ligjet ndërkombëtare të luftës. Nuk i njihnin e nuk i pranonin institucionet e vëndit. Në shumicën e rasteve këto vrasje të paligjëshme shoqëroheshin nga mendësia Kanunore e vrasjet ndiqnin njëra tjetra, e ku dhuna e egër e primitive mbizotëronte.

Ushtria gjermane në dokumentacionin e tyre për Shqipërinë i quanin të gjitha grupet e armatosura që luftonin me njëri tjetrin ose kundër tyre "Bandit" në kuptimin e formacioneve ushtarake të padisiplinuara.

Duke i studjuar, analizuar e bërë publike shkaqet, motivet, personazhet që kanë marrë pjesë në këto vrasje, si viktimat ashtu dhe vrasësit, besojmë se ndërgjegjësojmë njerëzit dhe mundohemi t'i japim gjykimin se këto vrasje masive, në fund të fundit, janë shprehje e një qytetërimi difektoz që ka nevojë të ridimensionojë vlerat e veta.

Duke i shpjeguar këto ngjarje larg banalitetit propogandistik politik unë shpresoj se, duke i zbuluar e ditur ngjarjet ashtu siç ka ndodhur në të vërtetë, do të ndërgjegjësojmë te qytetërimi ynë arsyesh-

mërinë e kontrollueshmërinë. Në këtë mendësi e shkruam studimin për vrasjet e 4 shkurtit 1944.

Pjesa e parë

4 Shkurti sipas gazetës "Bashkimi"

Studimin përbëhet nga ka disa kapituj që i lidh vetëm ngjarja e vrasjeve të 4 shkurtit 1944, jam bazuar në besueshmërinë e llojit të dokumentacionit që studjova për këtë temë, pjesa hyrse bazohet në shtypin e shkruar në vitet e para të çlirimit të Shqipërisë, pjesët vazhduese fokusohet në dokumentacionin arkivor të ish Ministrisë së Brëndëshme të regjimit komunist. Kam shtuar në fund të këtij studim dhe kapituj nga libri me titull "Xhafer Deva" të Idriz Lamaj. Në thelb ky studim është kryer nga ndjesia ime se propaganda historiografike enveriste në mënyrën më të pahijshme është fokusuar te figura politike e Xhafer Devës specifikisht, e "Kosovarët" në tërsi, që janë akuzuar e propaganduar nga propaganda komuniste e Shqipërisë për më shumë se 45 vjet si njerëz "vrastar, hajdut, grabitës, injorantë etj etiketime racore krahinor" e mbi të gjithë akuzohen ata përgjithësisht për vrasjet në ngjarjen e 4 Shkurtit 1944.

Qesharakja në këto "epitete" është se i shkruajnë njerëz që kanë prejardhjen nga një popullësi e Shqipërisë që sipas historiografisë enveriste ishte 90% analfabete. Po e plotësojmë panoramën e këtij

realiteti qesharak me fjalët e Konicës:

"E vërteta është që shqiptarët janë fshatarakë, primitivë dhe të korruptuar, dhe çfarëdo që të bëjë njeriu, ky popull për vetëqeverim nuk është i zoti. Me gjith' këtë, le të punojmë, pa illuzje edhe pa shpresë, për të shkuar kohën edhe për diletantizmë. Unë, të paktën, me këtë shpirt punoj, kur më teket. Ju përshëndosh me zemër, Faik Konitza."

Këto "epitete fyese" nuk më pengojnë që të jem objektiv në analizën historike që shkruaj.

Ju kujtoj se një pjesë e studimi bazohet në dokumentacionin e shkruar zyrtar të regjimit komunist ku besueshmëria e dokumentacionit është relativisht e lartë. Besueshmërinë mbi të vërtetën historike e ka vlera e lloji të dokumentacionit ku bazohet studimi.

Që studimi ynë të marrë një përgjigje sa më e afërt me të vërtetën e kësaj ngjarje po citojmë pjesë nga gazeta "Bashkimi" organ i regjimit komunist që është, në një farë mënyre hetimi i vetëm "zyrtar" për vrasjet e 4 shkurtit të vitit 1944 dhe që unë mendoj e besoj se është i vetmi hetim që është bërë nga pushteti komunist për këtë vrasje. Gjer më sot nuk ka ndonjë hetim për këtë ngjarje ka vetëm propagandë e subjektivizma delirantësh të pa logjikshëm.

Qasjet logjike që kanë pjesët e studimit, të cilat kanë këndvështrimet e autorëve për këtë ngjarje janë qëmtuar e futur në këtë studim që lexuesi sot me mëndjen e tij të ketë mundësi të nxjerri përfundime të drejta për vrasjet e 4 shkurtit 1944.

Ju bëj me dije se ndryshimi midis pjesëve të këtij studime, është se ndërsa pjesa e parë është një hetim gazetaresk propogandistik dhe si e tillë për-

mban në thelbin e saj doza mosbesuese për këtë variant të kësaj ngjarje, pjesa e tjera janë marë nga hetimet i organeve hetimore e ligjore të shtetit komunist ku dhuna fizike e psikologjike ka qenë një akt normal për ta, dhe ka besueshmërinë relative. Pjesët e marë nga librat autobiografik në vetvete kanë subjektivizmin e autorëve.

Po e shkruajmë studimin tonë si më poshtë:

Në gazetën "Bashkimi" të datës 3-4-5 shkurt 1945 shkruhen mjaft të dhëna për përkujtimin e "4 shkurtit 1944", e cilësuar nga historia komuniste si "Masakra e 4 shkurtit". Ne po citojmë pjesë nga kjo gazetë për të na ndriçuar mendjen për të vërtetën e kësaj dite makabre.

Gazeta "Bashkimi" në datën 3.2.1945 në faqen e parë në fund djathtas me shkrim të theksuar jep këtë lajmërim si më poshtë

“Ftohen familjet, far e fis, ose shokët, dhe çdo qytetar, që di emrat e martirëve të 4 shkurtit 1944, t'i njoftojë brënda ditës së sotme pranë Këshillit Nac.Çl. të qytetit të Tiranës” Tomas Akuini filozofi katolik italian konstaton së merita e martirizimit qëndron në përballimin vullnetar të vdekjes, në rastin e viktimave të kësaj dite nuk më rezulton se viktimat kishin dëshirë të vdisnin për ndonjë arsye.

Kjo ftesë e gazetës për qytetarët e Tiranës për të marrë të dhëna për ngjarje e 4 shkurtit 1944 është një tregues se pushteti komunist nuk ka një informacion të saktë rreth kësaj ngjarje, thjesht deri tani ajo e ka propaganduar këtë ngjarje për qëllimet e saja politike duke shfrytëzuar efektet emocionale e tronditës që ka lënë kjo ngjarje te kryeqytetasit, e në të vërtetë nuk di as numrin e të vrarëve, as shkaqet

e as emrat e viktimave të kësaj dite dhe më e çuditshme nuk i dinë emërat e antetatorëve që provokuan këtë ngjarje. Thjesht dihet se janë bërë vrasje masive në Tiranë, e pashembullt deri në atë ditë të luftës që është bërë në Shqipëri, nga krahu kundërshtar i komunistëve. Vrasjet masive pa gjyq që formacioni ushtarak “Nacional Çlirimtarë” e drejtuar nga komunistë kishin bërë në Shqipëri gjatë luftës akoma nuk ishin bërë publike.

Në një deklaratë të gjatë me titullin "Për 4 shkurtin" të botuar në gazetën "Bashkimi" të firmosur nga Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste Shqiptare mbasi kishte shumë fjalë për kujtimin e të vrarëve dhe për hakmarje që do të bënin komunistët, shkruhej se janë vrarë rreth 80 vetë dhe po në këtë deklaratë jepen vetëm emrat e Todi Shkurtit, Vangjel Capen, Hasan Çeliku, dhe Mihal Koçi.

Emra të tjerë kjo deklaratë e botuar në gazetën “Bashkimi” nuk përmend. Në shtypin shqiptar të 45 vjetëve të qeverisjes komuniste vazhdimisht është shkruar për këtë vrasje të 4 shkurtit me shifrat 104 ose 80 vetë por pa saktësuar emërat e të vrarëve. Këto shifra ne s'i vërtetojmë dot sepse nuk e gjejmë të dokumentuara, por as pushteti komunist nuk i ka vërtetuar asnjëherë gjatë gjithë pushtetit të tij 45 vjeçar.

Po në këtë gazetë, ka disa artikuj për këtë eveniment të shkruajtur nga Sejfulla Malëshova në fuqshën e emocioneve e përjetimeve dhe nuk ka asnjë informacion të saktë, për të vrarët apo emrat e tyre.

Një artikull tjetër emocional për kujtimin e 4 shkurtit, të firmosur nga Demo Koti (Petro Marko) me titullin "Kush mungon, kush u vra" jepen këto

emra si më poshtë e të vrarëve të 4 shkurtit 1944.

Fadil Rada, Xhemal Sojli, Davi Koen, Sitki Çiço, Petro Prifti, Vasil Muzina, Gjergji Marangosi, Haki Huta, Dr. Pano, Emurdha Korra, Mihal Jani Koça, Rag. Ravesi, Sulejman Vrapì, Sokrat Tako, Ramiz Treni, Vangjel Cako, Harrito Harrito, Ali Visha, Mina Toma, Todi Shkurti, Gjergj Legisi, Islam Halla, Shyqëri Grablleshi, Hasan Rexhepi, Dhimitër Thoma.

Në këtë listim që ka shkruar Petro Marko në këtë gazetë janë gjithsej 25 njerëz të vrarë. Autori nuk na jep të dhëna për dokumentacionin që ka përdorur ose burimin e informacionit. Gjë e cila na krijon rezerva për listimin e numërin e të vrarëve.

Në një vënd të dukshëm të gazetës Bashkimi të datën 4.2.1945 është botuar një listë me emra të e cilat autori i cilëson si emrat e të vrarëve në 4 shkurt 1944.

Po e riprodhojmë artikullin si më poshtë.

"Martirët e 4 shkurtit 1944"

Xhemal Sojli, Sitki Çiço, Vasil Muzina, Haki Huta, Maliq Huta, Mihal Jani Koço, Sulejman Vrapì, Prof. Ramiz Treni, Vangjel Capo, Harito Harito, Ali Visha, Mina Thoma, Todi Shkurti, Fadil Rada, Gjergj Legisi, italian i pa identifikuar, Islam Alla, Hasan Rexhep Çeliku, Emurlla Kora, Sokrat Tako, Ragioner Ravesi (italian), Jorgji Marangosi (Malazes), ekzekutuar e vrarë te ura e Lanës, katër puntorë të pa identifikuar, para Sahatit, Italiani i ekzekutuar të Kodra e Kuqe, i pa identifikuar, Tre malazezë, të

nxjerrë nga burgu dhe të ekzekutuar në Kodrën e Kuqe më 4 shkurt, David Koen (nënshtetas Jugosllav), Dr.Stefan Pano, dy puntorë të pa identifikuar (vrrarë përpara xhamisë së Met Firës), Petro Prifti, tre të vrrarë në rrugën e Pishës dhe të pa identifikuar, Dhimitër Thoma, Shyqri Grëblleshi, Viçenzo Apel dhe një tjetër i pa identifikuar. Nji tjetër i pa identifikuar, vrrarë në Rr. e Dibrës kundrejt dyqanit të VII. Dabëtaku. Një tjetër i pa identifikuar, vrrarë para xhamisë E'them Bej.

Shkrimi nuk ka autor dhe unë besoj se është produkt i një frymëzimi gazetaresk i pa bazuar në dokumentacionin e duhur ose ndonjë referencë e besueshme mbi këtë çështje. Ka kontradikt me shkrimin e shkruar nga Petro Marko se ai në shkrimin e tij përmend 25 njerëz të vrrarë e ky shkrim e dyfishon shifrën e çon te 44 njerëz

Nga materialet e propaganduar për “4 shkurtin 1944” gjer tani vetëm këto emra janë deklaruar në shtypin shqiptar. Mendoj se ky është materiali i vetëm i shkruar që kemi e që mund të jetë marrë seriozisht me këtë ngjarje e që mundohet të japë të vërtetën në formën e një liste të emrave që janë vrrarë në këtë ditë. Në këtë shkrim janë dhënë gjithësej emrat e 44 të vrrarëve të cilët i kemi renditur si më poshtë.

23 njerëz kanë emrat e tyre dhe janë të kombësisë shqiptare.

2 njerëz kanë emrat e tyre dhe janë të kombësisë italiane.

2 njerëz janë të kombësisë italiane të pa identifikuar

- 1 njeri i kombësisë malazeze me emrin e tij.
- 3 njerëz të kombësisë malazeze të pa identifikuar.
- 1 njeri i kombësisë jugollave me emrin e tij.
- 6 njerëz të identifikuar si punëtorë
- 6 njerëz të vrarë por të pa identifikuar

Interesante është se kjo listë në asnjë rast nuk i përmend këta njerëz si element komunist ose njerëz që përkrahnin Nacional Çlirimtares, pyetja që shtroj unë e që nuk jam në gjëndje ti jap përgjigje është: Ç'përfaqësonin këta njerëz që u vranë sipas gazetarit, janë komunist, filo komunist, apo janë thjesht njerëz pa fat që u ndodhën në vendin e gabuar e në kohën e gabuar? Po antetatorët kundër Xhafer Devës e Kadri Cakranit që provokuan reagimin e dhunshëm të palës së goditur, kush ishin, kujt grupimi politik i përkisnin, ishin komunist apo nacionalist? Xhafer Deva në letrat e tija i trajtonte si kundërshtar të tij si komunistët dhe nacionalistët sipas gazetarit Idriz Lmaj.

Kjo listë që është botuar në gazetën "Bashkimi" lë shteg për shumë hamendësira për vërtetësinë e saj, sepse është produkt i një gazetarie dhe jo punë profesionale e një organit kompetent hetimor. Gjithashtu artikulli i gazetës nuk na tregon referencat dokumentare ose ndonjë referencë tjetër se ku u bazua në emërat e sasinë e njerëzëve në këtë artikull.

Për ta argumentuar këtë që shkruam më lart, po ju japim një shkrim tjetër të po kësaj gazete e cila në një farë mënyre është tregues i mosprofesionalizmit të autorit të kësaj ngjarje

Një artikull në gazetën "Bashkimi" ditën e premtë datë 9.2.1945 në faqen 3 në krahun e djathtë lart është botuar një artikull me titull - "2 heronj martirë të 4 shkurtit"

Po citojmë pjesë nga ky shkrim

-...Moti ma parë, me 9 fruer (shkurt) 1944, vdisnin nën tortura në duart e xhelatëve të popullit Ali Visha dhe Lake Sula. Të arrestuem natën e 4 shkurtit ata u çuan në burgun pranë Gjimnazit dhe natën e 9 shkurtit, nga ora 11.30 u morën në pyetje në Ministrinë e Mbrëndëshme.

Në këtë shkrim na del se Ali Visha nuk është vrarë në 4 shkurt por në 9 shkurt. Ju kujtoj se vëndi ishte në një luftë vllavrasëse dhe çdo ditë kishte luftime e lajme për të vrarë nga të gjitha palët, Shqipëria në këtë periudhë është në gjëndje anarkike, por ne në këtë shkrim merremi vetëm me të vrarët e datës 4 shkurtit 1944 dhe jo me të vrarët e Shqipërisë gjatë luftës së dytë botërore.

Dokumentet ushtarake gjermane të Tiranës në raportet e tyre që I dërgojnë shtabit qëndror gjerman për situatën e kësaj periudhe e përshkruajnë këtë ngjarje si një dukuri normale në një situatë lufte me një përshkrim të thatë e të saktë.

Në raportin ditor të Divizionit 297, të datës 3.2.44 shkruhet se "...Gjatë pasdites komunistët organizuan atentate ndaj drejtuesve nacionalistë. Ndër ta ishin edhe ministri Deva dhe Kadri Çakrani. Si pasojë, grupimet nacionaliste planifikojnë gjatë natës kryerjen e një kundërshtimi. Komandanti i Përgjithshëm (gjermane) urdhëron që trupat (gjermane) në Tiranë të rrisin nivelin të sigurisë duke udhëzuar gjithë trupat dhe instancat gjermane të

qëndrojnë larg këtij konflikti”.

Në një tjetër dokument gjerman i Deleguari Special për Europën Juglindore, Hermann Nojba-heri i drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtëme Gjermane me telegramin Nr 358

Beograd, më 17 shkurt 1944

“Situata në Shqipëri edhe më tej mund të konsiderohet e mirë. Shkatërrimi i bandave komuniste po vazhdon edhe më tej. Në vetë qytetin e Tiranës, me aksione të vrazhdëta të pastrimit nga ana e forcave nacionale, është shkatërruar aparati partiak komunist. Qeveria po fiton teren, po jetësohet formimi i policisë dhe i xhandarmërisë, me ç’gjë po zhvillohet forcimi i mëtejshëm.

Nga analiza e dokumentit gjerman lindin natyrshëm disa pyetje: Çfarë nënkupton funksionari gjerman me emërtesën “Forca nacionale” ai pretendon se është shkataruar “Aparati partiak komunist” gjë që nuk më rezulton i vërtetë, ai pretendon se “qeveria po fiton teren” Realisht mbas ngjarjeve të 4 shkurtit 1944 lindën shumë mosmarveshje midis antarëve të qeverisë, Regjencës e Ministrit të Brëndshëm, Xhafer Deva, ai u akuzua si i dështuar që nuk mori masat e duhura që ngjarja të mos kishte ndodhur, indirekt e akuzonin atë për këtë ngjarje më vonë Xhafer Deva dha dorheqjen nga qeveria dhe një nga arsyet ishte dhe pasojat politike e mosbesimet reciproke të liderëve të kohës që krijuan vrasjet e 4 shkurti e vitit 1944.

Pjesa e dytë

Po për këtë ngjarje po japim rrëfimet e dy nje-rzëve që kanë qenë prezent fizikisht në politikën shqiptare të kohës dhe mjaft të besueshëm në rrëfimet e tyre për vetë formimin e tyre personal dhe funksionet që ata kanë pasur në atë kohë anarkike e politike për Shqipërinë

Rrëfime për vrasjet e 4 Shkurti të vitit 1944

Shkrimi i mëposhtëm është bazuar në rrëfimet në hetuesinë komuniste të zotit Isuf Shaban Deva i cili ka qenë sekretari i Xhafer Devës, Ministër i Mbrëndshëm i Qeverisë së Rexhep Mitrovicës.

Dosja Nr.2064/A

(Arkivi i Ministrisë së Brëndshme)

Pak ditë mbas kapitullimit të Italisë, Xhafer Deva ndodhej në Prizeren ku më thërret dhe mua. Unë shkova në Prizeren së bashku me një delegacion prej Mitrovice, Vuçiterne, Peje dhe vendeve të tjera të Kosmetit (Kosovë e Metohi). Në Prizeren u theme-lua Lidhja e Dytë e Prizerenit. Në krye të Lidhjes së Dytë të Prizerenit ishin Bedri Pejani, Xhafer Deva, Profesor Mark Gjini etj. Kryetar i Lidhjes u zgjodh Bedri Pejani.(Lidhja e dytë e Prizerent në 16 shtator 1943 zgjodhi si kryetar Rexhep Mitrovicën por mbasi

ai u emërua kryeministër i Shqipërisë në 5 nëntor 1943 vëndin e tij si Kryetar i lidhjes së dytë të Prizerent u zgjodh Bedri Pejani Aj)

Lidhja e dytë e Prizerenit kishte karakter politik. Ajo synonte në organizimin administrativ të Kosovës, bashkimin e forcave të armatosura dhe së bashku me gjermanët me rujte këtë vend. Armiku kryesor i Kosovës në këtë kohë ishin çetnikët serbë dhe komunistët serb e shqiptarë.

Unë Isuf Deva kamë qenë Sekretar i Lidhjes së Dytë me kuptimin e administratorit. Në këtë kohë në Tiranë formohet Qeveria e Rexhep Mitrovicës, ku Xhafer Deva merr funksionin e Ministrit të Brëndshëm. Xhafer Deva vjen në Tiranë së bashku me "Regjimentin Kosova"¹ shoqëruar nga Bedri Pejanin², Masar Sopotin³, Beqir Malokun⁴ shoqëruar dhe nga njerëzit e tij besnikë si Tefik Bekteshi nga Mitrovica, Gani Ibrahimimi nga Mitrovica, Nexhip Musa nga Mitrovica, Ram Tutica nga Pazari i Ri, Riza Korashi nga Gjakova, Rexhep Budakova nga Prizereni.

Këta kanë qenë antarë të Regjimentit "Kosova" dhe na informonin për qëndrimet politike të popullsisë të Tiranës. Gjithashtu na jepnin listat emërore të familjeve dhe personave të lidhur me Levizjen Nacional Çlirimtare. Mua Xhafer Deva më thërret nga Kosova dhe me cakton sekretarin e tij privat.

Në datën 3 Shkurt 1944 komunistët i bëjnë atentat dhe vrasin nipin e Xhafer Devës, Fahri Ibrahimini, (djali i dajës) i cili kishte ardhur në Tiranë për punë dhe nuk merrej me politikë. Me rastin e atentatit që ju bë nipit të Xhafer Devës në Hotel Dajti, u mbloodhën së bashku, Tahir Kolgjini, Hysni Dema, Kadri Cakrani, Xhelal Staravecka, Xhelal

Mitrovica, Rrok Nallbani, Mato Murati, Beqir Maloku dhe mandej, kur vdiq nipi i Xhafer Devës (Fahri Ibrahimimi u plagos randë dhe vdiq mbas pak kohe në spital) këta erdhën në shtëpinë e Xhafer Devës nga ora 19 për ngushëllim.

Ishte disa orë para mesnatës së 4 Shkurtit të vitit 1944 kur u përpiluan listat e familjeve e personave te Nacional - Çlirimtares mbi të cilin do të binte hakmarrja e terrori. Si u vendos përfundimisht lista në shtëpinë e Xhafer Devës, këta u ngritën dhe shkuan në Ministrinë e Mbrëndëshme, unë shkova në shtëpi.

Lista e njerzëve ka dalë nga Arkivat e Ministrisë së Brëndëshme të Xhafer Devës.

Në orën 22, 30 të kësaj nate me thërret Xhafer Deva në Ministri ku dhe shkova. Në zyrën e Xhafer Devës erdhi dhe Kadri Cakrani, Qazim Mulleti dhe Hysni Dema.

Xhafer Deva me urdhëroi që të shkoja te Qazim Mulleti i cili caktoi sektorët e veprimit për hakmarrje, mbaj mend se për këtë natë kishim në dispozicion për të vepruar 200 deri 300 vetë të armatosur të cilët bëheshin nga Regjimenti "Kosova", nga Xhandarmëria dhe elementa besnikë të Kadri Cakranit, Qazim Mulletit etj. të cilët u ndanë në vende të ndryshme. Drejtimit që duhej të merrnin i dhanë Xhafer Deva dhe Qazim Mulleti, me vete, grupet e armatosura kishin të gatshëm listat e njerëzve që do arrestoheshin.

Në këtë terror u arestuan 320 vetë të cilët qëndronin pranë Ministrisë së Mbrëndëshme nëpër burgjet e saj. Përgjegjës për kontrollin dhe arrestimet kanë qenë këta persona: Beqir Maloku, Qazim Mu-

Ileti, Mato Murati, Xhelal Staravecka, Hysni Gradeci nga Podujeva, Qemal Mujku nga Mitrovica, Ibrahim Murati nga Mitrovica.

Pushkatimi i këtyre filloi në orën 1 mbas mes nate dhe nëpër rrugët e lagjeve të ndryshme për qëllim paniku nëpër elementë të Lëvizjes Nacional - Çlirimtare. Viktimat e këtij terrori u lanë nëpër rrugët e qytetit deri në mbrëmjen e 4 Shkurtit.

Në 4 Shkurt unë kam marrë vesh se janë vrarë rreth 80 vetë e mbi 200 të tjerë u arrestuan e u burgosën.

Si është bërë terrori, ne nuk kemi bërë ndonjë mbledhje për të bërë ndonjë llogari mbi veprimtarinë që ishte bërë. Nga të gjithë ata që kanë vrarë më tepër në terrorin e 4 Shkurtit ka qenë Xhelal Staravecka, por sa ka vrarë, nuk ma ka thanë.

Mbas kryerjes së terrorit të 4 Shkurtit, midis Qeverisë Mitrovica e Ministrit të Mbrëndëshme Xhafer Deva lindën kontradikta, qeveritarë të ndryshëm të kësaj qeverie e kritikonin aktin e 4 Shkurtit.

Në këtë kohë lëvizja komuniste në Kosmet rritet dhe duke u ndodhur në një situatë grindjesh në qeveri dhe përpara rritjes të luftës Nacional - Çlirimtare në Kosovë, Xhafer Deva braktis postin e Ministrit dhe niset në Kosovë për të shuar lëvizjen komuniste, së bashku me njerëzit e tij besnikë. Xhafer Deva në këtë rast bëhet Kryetar i Lidhjes së Prizerenit.

Shënim.

E para, shumë nga emrat e njerëzve që Isuf Deva implikon në rrëfimet e tij që kanë marrë pjesë në terrorin e 4 Shkurtit të vitit 1944, nuk janë përmendur ndonjëherë publikisht në historiografinë ko-

muniste për këtë çështje, gjë e cila le për të dyshuar në vertetësinë e këtij rrefimi, njëkohësisht duhet të marrim në konsideratë faktin se ndaj Isuf Devës është përdorur dhuna fizike nga organet e Ministrisë së Brëndëshme dhe rrëfimet janë marrë me dhunë. (D 2064/a f.10.)

Theksoj se në këtë shkrim, kam shkruar një nga format e rrëfimit të Isuf Devës për këtë çështje, sepse hetimi i kësaj çështje është bërë në një kohë relativisht të gjatë dhe ku Isufi vazhdimisht rrëfehej për këtë çështje, jepte variante të ndryshme për numrin e të vrarëve dhe për emrat e pjesëmarrësve në këtë vrasje. Në këto ndryshime ka diferenca për numrin e njerëzve të vrarë, gjithashtu informacionin për numrin e viktimave e ka të marrë gojarisht nga njerëz të tjerë, sepse përdorte vazhdimisht shprehjen “kam marrë vesh se atë mbrëmje u ekzekutuan....”

Epilogu i Isuf Devës

Isuf Deva u arrestua në Zagreb në datën 11.6.1945. UDB Jugosllave në datën 24.11.1945 e dorëzon Isuf Devën në organet e Ministrisë së Punëve të Brëndëshme Shqiptare. Në datën 30.1.1947 e pushkatuan.

Shënim: Nipi i Isuf Devës, Agim Deva pohon se axha i tij është arestuar në Sarajeve e jo në Zagreb.

Rrëfime për vrasjet e 4 Shkurtit 1944

Ky rrëfim është bazuar në thëniet në hetuesinë komuniste të zotit Musa Gjylbegu me profesion agronom, me arsim të lartë të mbaruar në Gjermani, zotërues i tre gjuhëve të huaja, gjermanisht, italisht e frengjisht. Në qeverinë e Rexhep Mitrovicës ai kishte postin e Ministrit të Botores. Ky material ka dalur nga dosja e tij gjyqësore.

Për ngjarjen e 4 Shkurtit kam këtë dijeni:

Me 3 Shkurt 1944 në Tiranën e re, Kadri Cakranit i bënë një atentat, ku ju vranë dy djem që i kishte pas vetes dhe një i plagosur nip, a kushuri nuk e di se ç'e kish. Aty vritet dhe nipi i Xhafer Devës, djali i vëllait që ishte me automobilin e Xhaferit, që e kishte marrë ai.

Nata që do njihej si “nata e 4 Shkurtit”, Xhafer Deva me Kadri Cakranin vendosën të bëjnë terrorin dhe në mëngjesin e 4 Shkurtit u gjetën 84 njerëz të vrarë. Unë këtë çështje e mora vesh në mëngjesin e 4 Shkurtit nga një dibran nëpunës që quhej Jemin Çuçi, Ky vjen me një tjetër që i kishin marrë të vëllanë dhe erdhën të më luteshin që të interesohem t'ja shpëtoj, po të ishte gjallë, këta më thanë që na kanë marrë mbrëmë vëllanë profesor, kanë marrë dhe të tjerë, por me thanë që ne interesohemi për vëllanë tonë, mbasi shumë i kanë vrarë.

Unë telefonova në Ministrinë e Brëndëshme por Ministri nuk ishte në zyrë. Sekretari privat i tij Isuf Deva më tha: Atë punë e di vetë Ministri por ai

s'është aty mbasi ka xhenaze në shtëpi, i kanë vrarë nipin.

Unë atëhere shkova te Kryeministri Rexhep Mitrovica dhe ai më foli për vrasjet që janë bërë dhe pastaj me tha: Djemtë e Kadri Cakranit për hakmarje të atentantit, janë çuar e kanë bërë disa vrasje. Ministria e Brëndëshme mbasi nuk kishte forca të mjaftueshme e pa të nevojshme që të marrë masa mbrojtëse për ata që ishin të dyshimtë dhe për t'i siguruar, i mori dhe i futi në burg, mandej e pyeta se sa të vrarë ka kjo punë, e ai me tha pesë gjashtë vetë, por hollësi nuk kam akoma, por do t'i marr shpejt.

Unë prej këndej shkova tek Mehdi Frashëri, në zyrën e Mehdiut gjeta Lef Nosin, Mihal Zallarin, Lame Karecon, dhe Sotir Kondin. Mihal Zallari me këto dy të fundit kishin vajtur e i ishin lutur Mehdi Frashërit që të urdhëronte lirimin nga burgu të Qirjako Haritos, mbasi Harito Harito atë natë u vra. Ai, në prezencën time, premtoi lirimin e tij. Mbasi shkuan ata, e pyeta për ngjarjen se ç'ka ngja, sikur nuk dija gja, dhe ai me tha: Djemtë e Kadri Cakranit kanë ba një reprezalje për atentatin që u është bërë mbrëmë, ku janë vrarë disa vete, por numri ekzakt nuk dihet.

Ministria e Brendëshme ka shtirë disa persona të dyshimtë në burg që të mos vriten dhe këta, prej këtyre njerëzve. Me të qitur xhenazen e të nipit, Xhafer Deva besoj do vijë të më japë skjarime të shkur tëra, unë i thashë se jashtë flitet se janë vrarë 70 apo 80 vetë, ai me tha: Nuk besoj të jenë kaq.

Kur erdhi mbas tre - katër ditëve Xhafer Deva në Këshillin Ministrues ku ishte dhe Këshilli i Naltë,

Xhaferi tha: Çështja e 4 Shkurtit ngjau nga disa djem të Kadri Cakranit që sot nuk gjenden këtu fare, këta e banë për hakmarje për atetatin e 3 Shkurtit. Ministria e Brendëshme, mbasi nuk kishte forca të mjaftueshme t'i siguronte jetën jashtë, i arrestoi dhe i futi mbrënda një sasi njerzish të dyshimtë.

Njerzit që janë vra janë shtatë-tetë vetë, jo më shumë. Ju tha Xhafer Devës se opinioni publik flet për ty dhe se janë tetëdhjetë e sa vetë dhe jo sa thua ti. Ai thoshte se këto fjalë nuk janë të vërteta. Opinioni publik dhe Këshilli i Naltë ishte i mendimit që këtë punë e bëri ai me Kadri Cakranin.

Për këtë çështje nuk u mor ndonjë masë as nga Këshilli Ministrues, as nga Këshilli i Naltë sepse e kishin frikë Xhafer Devën. Këshilli i Naltë mori si masë heqjen e kompetencave në stil të gjërë të veprimeve të Ministrisë së Brëndëshme dhe e mori vetë komandën ushtarake sepse me parë e kishte Ministria e Brëndëshme kompetencën e Gjindarmërisë

Shënim:

Në këtë rrëfim të Zotit Musa Gjylbegut për vrasjet e 4 Shkurtit ka shumë pika të përbashkët me rrëfimin e Zotit Isuf Deva, ashtu siç ka dhe mospërputhje. Një nga mospërputhjet është se në këtë rrëfim implikohen si autorë të vrasjeve vetëm Kadri Cakrani dhe njerëzitë tijë, implikohet dhe Xhafer Devën, megjithëse ky i fundit e mohon këtë akuzë dhe shprehet se vrasjet i ka bërë për hakmarje Kadri Cakrani kurse në rrëfimin e Isuf Devës implikohen shumë vetë në këtë vrasje.

Pjesë e mëposhtëme është marë nga dosja

Gjyqësore-Hetimore me Nr 1086 A i Arkivit të Ish Ministrisë së Brëndëshme të regjimit komunist shqiptar që na jep informacion për 4 shkurtin e vitit 1944

Në këtë dosje të akuzuar ish-in ish kryeministri i Shqipërisë Maliq Bushati dënuar me vdekje, Lef Nosi - Regjent i dënuar me vdekje, Patër Andon Harapi - Regjent i dënuar me vdekje në vitin 1946.

Më poshtë po japim pjesë nga pohimet në gjyqin e tyre që kanë bërë Lef Nosi e Padër Anton Harapi në përgjigje të pyetjeve të prokurorit të çështjes Misto Treska për ngjarjen e 4 shkurtin e vitit 1944

I pandehuri (Lef Nosi): Regjenca okupatorin e luftonte, gjithashtu përpiqeshim që popullit ti pakësonim vuajtjet. Më 4 shkurt unë kam qenë në Elbasan, kështu që nuk di gjë për këtë çështje. Unë 4 shkurtin e kam me të dëgjuar.

Ata që u vranë në 4 shkurt ish-in popull dhe për këtë janë përgjegjës direkt ata që i vranë. Regjenca nuk dinte se kush kryente dëme në popull. Ata që u vranë në 4 shkurt ish-in patriot dhe këtë veprim e bëri Ministri i Brëndshëm Xhafer Deva. Në terrorin e 4 shkurtit morën pjesë kosovarët që komandoheshin nga Xhafer Deva e Xhelal Staravecka. Nuk di në se ishte edhe Kadri Cakrani, por mund të ketë qenë Kadriu i cili ka qenë eksponent i parë i Ballit Kombëtarë. Kur u ktheva nga Elbasani kemi thirrur qeverinë e kryesuar nga Rexhep Mitrovica dhe u hoqëm vërejtje duke kërkuar që të gjënden autorët që kryen terrorin e 4 shkurtit, dhe për veprën e 27 shkurtit 1944 neve i kami tërhequr vërejtje qeverisë.

Shënim:

Nga pohimet e Regjentit Lef Nosi lexojmë të njëjtën përgjigje si të tjerët që kanë rrëfyer në këtë shkrim për këtë ngjarje “unë për vrasjet 4 shkurtin e kam me të dëgjuar se kam qenë në Elbasan” më tërhoqi vëmëndjen që në pohimet e tija para prokurorit, Lef Nosi viktimat e 4 shkurtit nuk i quan komunistat por popull e patriot. Ai akuzon Xhafer Devën e Xhelal Staraveckën për këtë ngjarje megjithëse ai nuk ka qenë në Tiranë atë ditë, gjithashtu implikon dhe Kadri Cakranin. Lef Nosi ka pasur kontradikta me Xhafer Devën sepse ky nuk pranonte të lironte nga burgu mbesën e Lef Nosit që ishte komuniste, ose përkrahëse e tyre nga familja e Lef Nosit ishin disa komunistat që kanë bërë karrierë në rregjimin enverist. Mbesa e tij u lirua nga burgu kur Lef Nosi kërcënoi se do tërhiqej nga Regjenca.

Të njëjtën pyetje të prokurorit Misto Treska, Padër Anton Harapi i përgjigjet:

I pandehuri (Patër Andon Harapi): 4 Shkurtin e bënë shqiptarët dhe jo gjermanët, këtë e bënë Xhelal Staravecka me shokë kurse unë dhe Lef Nosi nuk kemi patur fare dijeni, nuk e di nëse ishte në dijeni të këtij veprimi Mehdi Frashëri. Nuk di çka bërë Ministria e Brëndëshme dhe Xhafer Deva dhe nëse këta kanë lajmëruar komandën gjermane për veprimet e kryera më 4 Shkurt, por di se këto veprime i kanë bërë pa dijeninë tonë.

Gjindermaria mvaresh nga Regjenca dhe se kjo (xhandermëria) ka marë pjesë në 4 Shkurtin, por këtë terror të 4 Shkurtit e ka bërë Xhelal Stravecka me Xhafer Devën, unë për veten teme nuk kam qenë

në dijëni të këtij veprimi. Nuk di gjë gjithashtu nëse kanë qenë ose jo civila në terrorin e 4 shkurtit.

4 Shkurtin e kanë shqiptarët, pasi ikën gjermanët nuk ishim ma të zot të bënim 4 shkurtat pse kur iku gjermani autoriteti i shtetit u çkatarua. Për veprën e 4 shkurtit, Xhafer Devës i hoqëm vërejtje dhe për 27 Shkurtin i hoqëm vërejtje. Unë në fjalimin tim jam shpreh kundër vllës vrasjes. Vllës vrasje banin Nacional Çlirimtarët me Ballin. Të luftosh kundër gjermanit nuk është vëllës vrasje, unë në fjalimin tim nuk kam thanë se Nacional Çlirimtarja po vrasin Ballin Kombëtar ose Balli Kombëtar po vret Nacional Çlirimtarët, por kam thanë se është dam me u vra vllës me vllës. Unë për veten time thom se më parë duhet me formue ndërgegjen kombëtare e mandej ndërgegjen ndërkombëtare. Komunistat ishin ekstremista.

Shënim:

Në pohimin e tij para prokurorit Misto Treska, të Padër Andon Harapi ai thekson se ai si Regjent nuk ka pasur dijëni për këtë aksion të dhunshëm, ai vazhdon e thotë se terrorin e bënë shqiptarët e jo gjermanët dhe akuzon Xhelal Staraveckën me shokë, gjithashtu ai akuzon xhandërmërinë se ka marrë pjesë në këto vrasje, gjithashtu akuzon dhe Xhafer Devën e njëkohësisht thotë që i tërhoqëm vërejtje Xhafer Devës si Ministër i Brëndshëm që nuk mori masat për të evituar këtë ngjarje, ai thekson se në këtë ngjarje nuk kanë marrë pjesë civila.

E ke të vështirë ta gjykosh frazën e Regjentit Harapi kur akuzon Xhafer Devën nëse ka qenë pjesëmarrës direkt në vrasje apo si dështim i tij si Min-

istër i Brëndshëm që nuk e parandaloi vrasjet e për këtë ju tërhoq vërejtje. Gjithashtu me frazën “Civila” unë besoj se ai nënkuptonte grupet e ndryshme shqiptare të armatosura që vepronin në zonat e tyre përkatëse në atë situatë anarkie që ishte Shqipëria.

Xhelal Staravecka tregon:

- Për ngjarjen e 4 shkurti të vitit 1944 po ju tregoj pjesë nga libri i Xhelal Staraveckës me titull “Përpara gjyqit të Historisë” në faqen 324 të këtij libri me nënëtitull “nata e Shën Bartolomeut në 4 shkurt 1944” ...në atë masakër nuk kam marrë pjesë, pasi komandën e xhandarmërisë së kryeqytetit e mora në 13 shkurt. E në sa i takon asaj çështje, kam dëgjuar se edhe qeveria e Tiranës e regjimit të sotëm nuk më ka dënuar. Atë gjak e ka bërë regjimenti “Kosova” i urdhëruar nga Ministri i Brëndshëm Xhafer Deva, në bazë të një liste përgaditur për të gjatë ditës në bashkëpunim me Ballin. Ministrin të Brëndshëm Xhafer Devës, njësitin komunist i vrau xhaxhain dhe komandantin të përgjithshëm të ballit, Kadri Cakranit, i vrau një nga shërbëtorët e tij. Meqenëse Tirana ishte stan pa qen, Kadri Cakrani dhe Xhafer Deva ishin të mjaftueshëm të bënin atë masakër që bënë. Nga aksioni komunist u bë ajo kasapanë atë natë që iu kushtoi jetën më tepër se shtatëdhjetë personave të pafajshëm.

Shënim:

Në rrefimin e tij Xhelal Staravecka thekson se

ishte antetatet e komunistave që kryen kundër Kadri Cakranit e Xhafer Devës që krijoi shkakun e kësaj masakre.

Kadri Cakrani tregon:

- Në vazhdën e dëshmimeve për këtë ngjarje po citoj një përmbledhje nga libri i Kadri Cakrani “Të vërtetat e luftës time” Në librin e tij autobiografik shkruan midis të tjerave dhe për 3-4 shkurtin 1944. Faqe 384-394 (përmbledhje) Ishja në Tiranë dhe ishte kaluar dreka... e vajtëm në kafenen “Kursal” E kishja pirë kafënë për gjysëm kur dëgjova disa të shtëna e krisma dhe një breshëri plumbash, jo shumë larg... kishin sulmuar maqinën time duke kujtuar se unë ishja aty, shoferi im ishte vranë e nipi im Isa Xhindoli ishte plagosur por po qëllonte me pistoletë. Nga shkëmbimi i zjarrit midis antentatorëve e njerëzve të mij e xhandarmërisë që po patrullonte në rrugë u vranë 4 antentorët. Erdhi Ministri i Brendshëm Deva e tha: i gjetëm kush ishin, janë nga Fieri ishin nisur për tju vranë juve, por kjo u shoqërua dhe nga antetatorët e Tiranës që i kishin bërë antetat makinës së Ministrisë të Brendshëm Deva. Nga shkëmbimi i zjarrit me ta mund të kem dhe unë dy të vdekur tha Deva. Antetatorët kishin bërë antetat dhe makinës së Xhafer Devës dhe kishin plagosur rëndë nipin e tij që më vonë vdiq.

Xhafer Deva në debat me Kadri Cakranin i tha atij: - Unë si Ministër jam kategorikisht kundër përzierjes së forcave të Ballit që është një organizatë dhe nuk ka lidhje me qeverinë. Ja ku i kam emrat i ke nesër të gjithë pas hekurave. U shpall “copri fuoci”

(ndalim qarkullimi). Gjithë natën të shtënat nuk pushuan, ku terroristët hidhnin dhe ndonjë bombë, pasi xhandermëria e kishte të ndaluar ti përdorte bombat. Atë natë ata që kishin dalur natën në “copri fuoci” ishin goditur në vënd, si shkelës së saj, të kuq apo jo. Operacioni meqense ishte lajmëruar me radio të gjithë të kuqtë kishin ikur nga Tirana. Gjatë natës u vranë nja 7-8 vetë dhe ne i vramë katër vetë në shkëmbimin e zjarrit me ta kur na bënë atentat. Të nesërmen në mëngjez copri fuco u mbyll më vonë. Tirana atë të premtë mezi doli për pazar nga frika. Komunistët mbushën traktet dhe fletushkat e tyre me masakra e terror, me afro 100 vetë të vrarë... miletin i futën frikën për Ministrin Deva, vetë që e nisën me të vrarë, bënë sikur ishin viktima duke ç’pikur dhe shtuar vetë sa u vranë. Komunistët për intrigë, nuk kishte njëri që tu dilte.

Shënim:

Kujtimet e Kadri Cakranit janë shumë të afërta me kujtimet e Xhafer Devës, njëkohësisht ai na informon se antetatorët në përleshje me armë më njërëzitet e tij e xhandarët janë vrarë. Interesante është se ai flet për trakte dhe fletushka për këtë ngjarje të hedhura nga komunistët fatkeqësisht nuk disponojmë ndonjë nga këto trakte as historiografia eneveriste si ka përmendur kurrë.

- Një tjetër informacion interesant është në pjesën e mëposhtme të shkrimit, ku në pyetjen time drejtuar Prof. Nexhmedin Spahiut, për ngjarjen e 4 shkurtit, Prof. Spahiu nga Mitrovica e Kosovës kujton: Kam pasë takuar dy ish xhandarë nga

Mitrovica që tani kanë vdekur por që kanë marrë pjesë në ngjarjen e 4 shkurtit si pjesë e regjimentit “Kosova” ata më kanë thënë: “Ne kishim urdhër të mos qëllojmë, vetëm në rast vetmbrojtje e sipas rregullave të qëllohet mbi agresorin. Komunistët në natën e 4 shkurtit 1941 në ikje e sipër nga frika e arsetimit ose vrasjes hidhnin bomba dhe vrisnin njerëz të pafajshëm vetëm për të shpëtuar veten e tyre, e në një rast e kanë vrarë njeriun e tyre që ne e kishim arestuar nga frika se mos i spijunonte. Këta dy xhandarë më kanë treguar për 8 të vrarë gjithësej në natën e 4 shkurtit 1944, pa llogaritur 5-6 atentatorë të një dite më parë të datës 3 shkurt që janë vrarë nga xhandarmëria e njerëzit e Kadri Cakranit në vetmbrojtjen e tyre ndaj atentateve kundër Kadri Cakranit e kundër Xhafer Devës. Nga atentatet e komunistëve u vranë shoferi i Kadri Cakranit dhe djali i dajës së Xhafer Devës.

Nexhmedin Spaihu 26.10.2024

- Në vazhden e shkrimit për vrasjet e datës 4 shkurt 1944 po japim pjesë nga libri “ Xhafer Deva - Jeta dhe Veprimtaria, New York viti 1980, fq. (42-85-86). e ribotuar në Prishtinë në vitin 2022 shkruar nga studjuesi e gazetari shqiptaro-amerikani Idriz Lamaj

Nga ky libër tepër interesant shkëputëm pjesë që kanë lidhje me studimin tonë për ngjarjen e 4 shkurtit 1944

Dr Rexhep Krasniqi shkruan për 4 shkurtin: Në një dosje të tij (Xhafer Deva) ndodhen dy letra të miat ku shihet se i kam bërë presion të shkruante rreth 4 Shkurtit dhe Regjimentit Kosova. Më bënte për-

shtypje heshtja e tij ndaj akuzave rreth masakrës së 4 shkurtit dhe gjoja rreth krimeve që kishte bërë ai. Xhafer Deva heshte dhe në qetësinë më të madhe shi-hej se nuk iu jepte asnjë rëndësi akuzave në fjalë. Vazhdimisht thonte: "Rexhepi i dinë të gjitha, ato janë shpifje, na nuk duhet të mirremi me gënjeshttrat e komunistëve."

Në një letër dërguar (Rexhep) Krasniqit (8.12. 1971) Xhafer Deva shkruan: "Idrizi (Lamaj) ngul kambë se këto nuk janë ma shpifje por akuza. Ai nuk po e ban dallimin midis shpifjes dhe akuzës dhe asht i mendimit se heshtja ime përforcon akuzën. Ai thotë: "Ju duhet patjetër të jepni versionin tuej dhe të shpjegoni rrethanat e ngjarjeve për të cilat akuzoheni, të pakten aq sa dini dhe aq sa mbani mend".

Idrizi i shkretë, nuk i dinë intrigat që janë thurë kundër nesh, nga të dy palët, nacionalistët dhe komunistët! Ai nuk dinë se unë jam akuzue edhe për vrasjen e atyne dy ballistave, nuk më kujtohen emnat e tyne, kur tanë Shqipnia e dinte se ata u grabitën prej djemve të Babë Myslimit dhe u ekzekutuen prej tyne, ose të atyne tjerëve që i pushkatuen gjermanet kur unë nuk isha hiç në Tiranë. Idrizi nuk dinë shumë gjana të asaj kohe..., etj." Unë nuk arrita ta bindë Devën të shkruante më tepër, megjithëse dy-tre herë përmendë në letrat e tij: "Nji ditë do të ulemi bashkë dhe do të shtrojmë muhabetin për këto çashtje."

Mbas vdekjes së Xhafer Devës, me insistimin tim, Dr. Rexhep Krasniqi shkroi diçka për 4 Shkurtin, në librin që përgatitëm për Devën:

Në fushatë e tërbuar kundër Kosovës menjëherë pas prishjes së marrëveshjes së Mukajt, gusht

1943, Partia komuniste e Shqipërisë, sigurisht me shtyrjen e organizatorëve të saj jugosllav, fillon një fushatë të ashpër propagandistike dhe vëllavrasje, sidomos kundër anëtarëve të Ballit Kombëtar. Njëkohësisht, komunistët organizojnë një fushatë të gjerë, pëshpëritjesh dhe të shtypit të tyre kundër Koso-vës dhe kosovarëve, me qëllim të kalkuluar, për të diskretituar idenë e Shqipërisë etnike, me të cilën Balli Kombëtar kishte fituar një plus në popull. Fushata në fjalë arriti një kreshçendo pas formimit të qeverisë së re dhe humbjeve luftarake e propagandistike që pësoi lëvizja bolshevike në Shqipëri, humbje në të cilat personalitetet politike e intelektuale kosovare, ashtu si dhe Regjimenti Kosova, kishin luajtur rol me rëndësi të dukshme. U vunë në qarkullim gjithfarë shpifjesh të ndyra, si bie fjala se kosovarët janë një masë injorante që kishin për të rrezikuar ekuilibrin e përbërjes së popullsisë shtetërore shqiptare, se ata janë katila, vrasin rininë tonë të pafajshme, ç'nderojnë vajzat tona, plaçkisin tregtarët dhe fshatarët", e njëmijë të zeza të tjera.

Në lidhje me sa u tha më sipër, këtu shenojmë një ngjarje të shëmtuar që ndodhi në Tiranë, në fillim të vitit 1944, e që është përdorë prej propagandës komuniste për të përhapur shpifje të tilla kundër kosovarëve. Dy oficerë të sigurimit publik, që nuk ishin kosovarë, kishin shpërdorë detyrën duke nxjerrë nga burgu dhe ç'nderuar dy partizane komuniste. Mbrenda orësh, me urdhërin personal të Ministrit Xhafer Deva, pas hetimeve të rastit nga një gjyq ushtarak, oficerët në fjalë janë dënuar me vdekje dhe janë ekzekutuar të nesërmen në mëngjes, në parkun e sheshit të sotëm Skenderbej. Banorët e atëher-

shëm të Tiranës janë 41 dëshmitarë për ngjarjen në fjalë, emrat dhe vendet e prejardhjes së tyre.

Edhe për aksionin e spastrimit që u krye me 4 shkurt 1944, kundër partizanëve komunist që përditë terrorizonin banorët e Tiranës e të krahinave të tjera me atentate brutale, me aksione plaçkitjesh të magazinave tregtare dhe të depove me ushqime e mallra të shtetit. Propaganda komuniste vjet përvjet mbushë botën me ulurimë dhe akuza hipokrite kundër kosovarëve dhe sidomos kundër Xhafer Devës. Doemos se aksioni në fjalë është kryer me pëlqimin e Ministrisë së Mbrendshme që kryesohej prej Xhafer Devës, por e vërteta është se “Regjimenti Kosova” atë natë ka kryer vetëm detyrën e rojes së zakonshme në qytet dhe nuk ka marrë pjesë në aksionet që ju kushtoj jetën disa komunistëve dhe terroristëve të njohur të tyre.

Aksionet në fjalë, gjithkush e dinë, në realitet janë kryer prej një grupi luftarësh që nuk ishin në shërbim të qeverisë dhe kryesoheshin prej z. Xhelal Staravecka, ish oficer shqiptar që ka qenë ndër udhëheqësit më aktiv të partizanëve komunist, në një shkallë me shokët Mehmet, Enver, siç e vërteton edhe Dushan Mugosha, njëri prej organizatorëve jugosllav pranë partisë komuniste shqiptare, në kujtimet e veta me titull: "Kur kam qenë në Shqipëri".

Në Shtator të vitit 1943, pas kapitullimit të Italisë fashiste, Staravecka, një njeri me ambicje patologjike, për arsye që vetëm mund të spekulohen, kaloi në anën e qeverisë së re të Tiranës. Në kalimin e vet, ndoshta për të shpjeguar shkaqet që e shtynë të largohet nga lëvizja komuniste, ai botoi një seri pamfletesh, në të cilat zbulonte metodat brutale dhe

aktet e torturave të tmerrshme të partizanëve komunist, kundër ushtarakëve italiane të zënë rob dhe të rinjëve shqiptarë që ishin rekrutuar me forcë nga partia." (Xh. Deva - Jeta dhe Veprimtaria, N.Y. 1980, fq. 42 85-86).

Krasniqi vazhdon në shkrimin e tij rreth efektit të thellë psikologjik të propagandës komuniste kundër kosovarëve në një pjesë të rinisë dhe popullsisë shqiptare në Shqipëri. Ai akuzon qeverinë komuniste të Tiranës edhe për masakrën e Tivarit. Simbas Krasniqit, afër 2000 kosovarë kalojnë duarlidhur nëpër territorin e Shqipërisë (Kukës-Shkodër), duke u pështyrë e thirrë me sharje "tradhëtarë të poshtër", dhe më në fund ekzekutohen nga forcat serbo-malazeze në Tivar.

Kapitulli i fundit:

Theksoj se të gjitha rrëfimet tona që janë në këtë studim, janë treguar nga personazhët tanë në formën e të dëgjuarit nga të tjerët dhe rrëfimet japin shifra të ndryshme se janë vrarë, gjë e cilën ne nuk e vërtetojmë dot se nuk kemi një hetim profesional ligjor të një organi kompetent, shifrat e gazetës Bashkimi dhe të personazheve tona nuk përputhen. Xhafer Deva i përfoluri kryesor i implikuar në këtë ngjarje por dhe Kadri Cakrani pohojn vetëm për 7 apo 8 vetë të vrarë.

Me të drejtë shtrohet pytja:

Sa janë vrarë në datën e 4 Shkurtit 1944?

Unë nuk di që të jenë publikuar ndonjëherë zyrtarisht emrat e viktimave të 104 apo 84 vetëve që pretendohet të jenë vrarë në 4 Shkurtin e 1944, nga propoganda komuniste.

Në asnjë vend të Tiranës nuk ka ndonjë pllakatë përkujtimore me emërat e këtyre të vrarë, kur në raste të tjera propoganda komuniste ka qenë tej mase e zellshme deri në abuzim për të afishuar viktimat e saj të luftës Nacional - Çlirimtare.

E kam të vështirë të arsyetoj propogandën komuniste se përse nuk i ka zënë kurë në gojë ose me shkrim emërat e antetatorëve të cilët u vranë në aksionin e tyre për të vrarë Xhafer Deven e Kadri Cakranin. Pikëpyetje e madhe!

Në përfundim, unë mendoj se pavarësisht se nuk e kemi të qartë mirë se kush është vrarë përse dhe sa është numri i saktë i kësaj dite të kobëshme, kjo vrasje është një shprehje e hakmarrjes tipike shqiptare për këtë kohë në Shqipëri, ku të gjitha palët ndërluftuese kanë bërë vrasje të tilla me përmasa të mëdha nën ndikimet emocionale të pa kontrolluara. Në luftën e Dytë Botërore, nga ana e komunistave kemi të dokumentuara sot vrasjet masive pa gjyq të 129 karabinerëve e oficerëve Italian, në Çermenikë Të Elbasanit, vrasjen po pa gjyq të 69 ballistave nga Golemi i Lushnjes, që ishin dorëzuar pa bërë luftë Mehmet Shehut e të gjithë u pushkatuan, në fund të vitit 1943 kemi vrasjen e 170 nacionalistëve në Shpërkë të Voskopojës. Pa llogaritur vrasjet ndëshkimore që rregjimi enverist bëri në Shqipëri kur morën pushtetin.

Për komunistët shqiptarë vrasja e kundërshtarëve politik nuk ishte shkelje ligjore.

Në këtë shkrim mendoj se kam dhënë të dokumentuar e të besueshëm një variant shumë të afërt me realitetin e asaj ngjarje të dhimbëshme për kombin shqiptar. Qëllimi i këtij studimi është që t'i vlerësojmë ngjarjet historike ashtu siç kanë qenë dhe të pa instrumentalizuar nga politika banale e ditës.

Gjithashtu shpresoj se ky shkrim do të na rrisë shpresën se bashkëkombasit e mi do nxjerrin përfundime të logjikëshme dhe do marrin vendime të arsyeshme e të urta (jo prej frike por prej burrnje - ka thanë Fishta) në raste të tilla që vëllavrasja për motive politike apo çfardo lloj motivi të mos përsëritet. Shqipëria nuk i ka bijtë e saj për t'u vrarë me njëri tjetrin, jemi shumë të pakët e të dobët në armiqësinë që na rrethon si komb.

Shënim:

Ky studim ka filluar të shkruhet në vitin 1996 po në këtë vit u botua në shtypin lokal të Tiranës te gazeta "Tribuna Demokratike" Me dijeninë time është studimi i parë i botuar për këtë ngjarje i studjuar larg mentalitetit propogandistik komunist. Më vonë kam lexuar shkrime e studime të tjera rreth kësaj teme nga autorë të ndryshëm, midis tyre më ka bërë përshtypje fakti që reagimi i propogandës ish komuniste për këtë ngjarje mbas botimit të shkrimit tim, dhe shkrime e të tjerëve për këtë temë, ka qenë shumë nervoze por në asnjë rast nuk kanë dalur nga

mendësia e tyre propogandistike anti kosovare e anti balliste dhe nuk na kanë ofruar asnjë dokumentacion të besueshëm për ato që shkruajnë, thjesht janë shkrime ku mllefi i verbër i ka verbuar arsyetimin logjik. Enveristëve u ishte prekur “miti”

Më vonë me gjetjen e dokumentacioneve të tjera që rrëfenin këtë ngjarje studimit të parë ju bashkëngjitën dhe pjesë të tjera të cilat ja risin vlerën e besueshmërisë studimit e duke u kujdesur për paanshmërinë e tij të plotë. Çdo pjesë ka datën e saj respektive kur janë shkruar e futur në këtë studim. Në datën 22.10 2024 ky shkrim u plotësua me informacione shtesë për 4 shkurtin, Një pjesë janë pohimet e Padër Anton Harapit dhe Lef Nosit dy Regjentët e Shqipërisë së vitit 1943 në procesin e tyre gjyqësor të vitit 1945-1946, një pjesë është marë nga libri me titull “Xhafer Deva” të autorit shqiptaro-amerikan Idriz Lamaj. Gjithashtu u futën në këtë studim pjesë nga librat autobiografik, të Xhelal Staveckës e Kadri Cakranit personazhe të përfolur për këtë ngjarje. Gjithashtu mu dukën shumë interesante kujtimet e Nexhmedin Spaihut për këtë ngjarje.

Ky studim historik është bërë në kohë të ndryshme e relativisht të gjata e vazhdimisht kam prirjen ta plotësoj kur kam mundësinë të gjej informacion dokumentar të besueshëm e plotësues rreth kësaj ngjarje.

Plotësime:

1. Regjimenti “Kosova”

Një regjiment ka afërsisht 800 burra të organizuara në batalione, por kjo varet nga numëri i rekrutuarëve e situatës ushtarake.

Në Shqipërinë e quajtur në atë kohë “Shqipëria e Madhe” situata e e sigurisë ishte kaotike, Ushtria italiane që kapitulloi nuk qe në gjëndje ta eliminonte kaosin në Shqipëri ku lufrat midis formacioneve politike shqiptare ishin të përditëshme. Vrasjet, antenatet e shturja po mbizotëronte në vënd. Forcat ushtarake të shteti shqiptar po dezertonin duke krijuar panik e kaos në vënd. Në këtë situatë dëshpëruese shumë personalitete të shqiptarëve të nxitur dhe të ndihmuar nga gjermanët u organizuan e formuan Regjencë, Parlamentin e Qeverinë, e në anarkinë që kishte pllakosur në vënd u munduan të formonin ushtrinë shqiptare, xhandarmërinë e të bashkëpunonin me forcat vullnetare të udhëhequra nga prinjës lokal. Gjenerali gjerman Bessel i tha gjeneralit shqiptar Aqif Përmetit “Ne gjermanët jemi të kënaqur kur shqiptarët marrin punët e brendëshme në dorë vet dhe ne okupohemi vetëm me detyrat tona ushtarake” (marë nga jetshkrimi Shefi i Shtabit i ushtrisë shqiptare Gustav Mirdash)

Gjenerali fuqiplotë Fitzthum kishte për detyrë organizimin e furnizimin me materialet përkatëse për trupat ushtarake shqiptare dhe stërvitjen e tyre nga oficerë gjerman. U arrit me shumë vështërsi

formimi i 4-5 baone (batalione) këmbësorie që kishin rreth 400-500 ushtarë për baon. Oficerët shqiptar që nuk kishin shërbyer në ushtrinë italiane kur u bë bashkimi i dy ushtrive në përgjithësi nuk ju përgjigjën thirrjes së Ministrit të Mbrojtjes për tu mobilizuar. U ideua bashkimi i të gjitha çetave vullnetare që ndodheshin nën udhëheqjen e krerëve të fiseve ose udhëheqësve të grupimeve politike në një ushtri kombëtare por dështoi.

Në fundin e vitit 1943 ushtria gjermane ishte në fazën e dëmtimeve të mëdha në të dyja frontet e luftës. Ajo s'kishte interes të riformonte ushtrinë shqiptare për të cilën nuk e respektonin si forcë serioze ushtarake dhe nuk e besonte. Asaj i interesonte të kishte një qetësi relative në Shqipëri ku akset kryesore rrugore, të ishin të sigurta për momentin e tërheqjes e ushtrisë gjermane. Aeroportet, vijën bregdetare ajo i mori nën kontroll duke besuar se është mundësia e zbarkimi anglez në bregun e detit Adriatik nga Shqipëri në Mal të Zi. Ajo bashkëpunoi ku pati mundësi me forca ushtarake vullnetare (ato i quanin banda) për të marrë më të mirën e mundëshme për ta në aspektin e qetësisë ushtarake. Trupat gjermane në Shqipëri kanë qenë shumë të rezervuara të ndërhyjnë në luftimet që bënin formacionet ushtarake shqiptare me njëri tjetrin. Ata ishin të kujdesshëm të mos ndërhyjnë haptasi në këto luftime duke repektuar sa mundëshin "Sovranitetin e Relativ të Shqipërisë" por edhe prej faktit se në qoftë se një ushtar gjerman vritej ata sipas ligjit të tyre ushtarak duhej të pushkatonin 100 njerëz në zonën ku vritet ushtari gjerman. Kemi rastin e vrasjeve në Borovë. Gjithashtu nuk ishte në interesin e ushtrisë gjer-

mane në kushtet kur ata po pësonin humbje të mëdha në të dyja frontet e luftës, të ndërhyenin në luftën për pushtet që bënë shqiptarët atyre ju interesonte rrugët kryesore e pikat strategjike ushtarake. *Nuk ishte në interesin gjerman ardhmëria e Shqipërisë. Qëllimi i tyre ishte menaxhimi i fuqive ushtarake që vepronin në vënd e që ishin antikomuniste, këta gjermanët u munduan ti kontrollonin, furnizonin, instruktonin e i përdorinin në interesin e tyre.*

Gjenerali i Plotëfushqishëm Gjerman në Shqipëri Fitzum, planifikonte krijimin e katër batalioneve shëtitës, të vendosur përkatësisht: një batalion në Elbasan, një në Tiranë dhe nga një batalion në Kukës dhe Prizren. Në kushtet e Shqipërisë për gjermanët ishte i rëndësishëm që sigurimin e rrugëve e qetësisë relative të tyre të përdroreshin çetat vullnetare, të cilët mershin material ushtarak italian, ushqim, etj materiale të nevojshme në kohë luftime ata ishin të gjithë nën urdhërat e gjermanëve. Por gjithsesi çetat vullnetare lokale e organizatave politike kishin relativisht lirinë e tyre të vepruarit për interes të tyre.

Emërtesat “Regjimenti Kosova” “Regjimenti Peja” janë organizime vullnetare për vetmbrojtje të Lidhjes së Dytë të Prizereni që së bashku dhe me shumë formacione ma të vogla vullnetare mundoheshin të përballonin sulmet e çetave nacionaliste, serbe, malazeze e njëkohësisht çetat komuniste të serbëve e malazesëve. Këto formacione drejtoheshin pjesërisht nga ushtarak shqiptarë ose drejtoheshin nga prinjësa fisnorë ose krahinorë. Në asnjë rast nuk e dokumentojmë që shteti shqiptar ose gjermanët të kenë ideuar e formuar regjimente me një emërtesë të tillë. Ata ishin vullnetar shqiptar shumica nga Kosova numëri i

tyre ishte në raport me situatën gjepolitike të Kosovës në radhë të parë në rast qetësie numëri nuk i kalonte 300 vetë në rast kërcënimi të kufitë të Kosovës nga sebët komunist e jo komuniste numëri shkonte deri te 1500 vetësh. Nuk ishin një formacion i mirëfillit ushtarak. “Regjimenti Kosova” si fuqi ushtarake vullnetare ka vepruar në teritorin e Shqipërisë së vitit 1913 nga Tetori i vitit 1943 e deri në fund të shkurtit 1944 ku u kthyen në Kosovë për të mbrojtur kufitë e Kosovës nga invazioni sllav.

2. Bedri Pejani

Ka lindur në Pejë, ka mbaruar shkollën fillore në vendlindje, arsimin e mesëm e ka bërë në në Shkup dhe të lartën në Stamboll, pjesmarës në revolucionin Xhon turk, parlamentar, diplomat, publicist, autor i shumë shkrimeve e përkthimeve, firmëtar i aktit të pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, simpatizues i komunizmit, fanolist, mbas dështimit të grushtit të shtetit 1924 emigron nga Shqipëria si anti Zogist, jasht atdheut është antarë i grupit të aratisur anti-zogist “Konare” më vonë pjesë e Kominternit komunist në emigracion ka banuar në Brindizi, Vjen, Zara, Berlin e Moskë. Intelektual i shquar për aktivitetin e tij majtist, atdhetar, politik, në vitin 1930 amnistohet e kthehet në atdhe. Pjesmarës në kryengritjen e Fierit e vitit 1935, dënuar me burg. Në vitin 1937 largohet përsëri nga Shqipëria për aktivitet anti Zogist e komunist e banon në Francë. Ka marrë pjesë në organizimin e dërgimin e vullnetarëve për në luftën civile në Spanjë. Aktivitet komunist për formimin e partisë komuniste shqiptare, pushtuesit Italianë e internojnë në Porto Romano të Durrësit si komunist. Në perudhën

e pushtimit të Shqipërisë nga gjermanët nëntor 1943-1944 është Kryetar i Lidhjes së Dytë të Prizerenit, arestohet në Shqipëri, Shkodër e i dorëzohet Jugosllavisë komuniste. Dënohet me vdekje, vdiq pa u ekzekutuar)

3. Masar Sopot

Intelektual, publicist, antar i Lidhjes së Dytë të Prizerenit përfaqësues i Tiranës, aktivitet atdhetar në Shqipëri e Kosovë

4. Beqir Malokun

Nga Gjakova funksionar shteti në Shqipëri e Kosovë shkollim fetar, aktivitet atdhetar në Kosovë e Shqipëri ka shkruar disa libra në imigracion në Itali

Literatura:

Gazeta “Bashkimi” shkurti i vitit 1945.

Dokumente të Ushtrisë Gjermane 1943-1944

Dosja Hetimore-Gjyqësore Nr.2064/A Ish Arkivi i Ministrisë së Brëndshme të rregjimit komunist (Gjykimi i Isuf Shaban Deva)

Dosja Hetimore-Gjyqësore Nr 193/A Ish Arkivi i Ministrisë së Brëndshme të rregjimit komunist (Gjykimi i Musa Gjylbegut)

Dosja Gjyqësore-Hetimore Nr 1086/A Ish Arkivi i Ministrisë së Brëndshme të regjimit komunist. (Gjykimi i Regjenti Pader Anton Harapi, Regjenti Lef Nosi, Kryeministri Maliq Bushtatit)